



**QYTETARË
TË INFORMUAR**

**QEVERISJE
E MIRË VENDORE**



1

Si mund të kontribuoj për një qeverisje të mirë vendore?

Gjithësecili prej nesh mund të kontribuojë për një qeverisje më të mirë lokale:

- Të gjithë gëzojmë të drejtën e informimit dhe aksesit në qeverisje, si një e drejtë themelore e individit por edhe parakusht për qeverisje të hapur, llogaridhënese dhe transparente: karakteristika të një sistemi të konsoliduar demokratik.
- Secili prej nesh ka të drejtën për të patur akses në dokumente zyrtare dhe institucionet shtetërore kanë detyrimin ligjor për ta përmbushur këtë të drejtë;
- Institucionet publike kanë detyrimin për të ofruar disa kategori të dhënash edhe pa patur nevojë për kërkesë të veçantë, etj¹.

2

Cilat janë mënyrat për të marë informacion në institucionet e qeverisjes vendore?

Mënyrat e informimit janë të shumta dhe të ndryshme nga njëra bashki në tjetrën, por më të përdorshmet janë:

- Faqet zyrtare të internetit / website-et e Bashkisë;

¹Ligj nr. 119/2014 Për të drejtën e informimit

- Programi i transparencës në faqen zyrtare të Bashkisë;
- Duke kontaktuar Koordinatorin e transparencies në Bashki;
- Sportelet e informacionit në secilën Bashki;
- Nëpërmjet dërgimit të kërkesave zyrtare për informim me e-mail apo dorazi;
- Duke marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në takimet e hapura me qytetarët dhe mbledhjet e hapura të Këshillit Bashkiak.

3

Çfarë duhet të përmbajë një kërkesë drejtuar Njësisë së Qeverisjes Vendore (NJQV)?

Në mënyrë që të mund të marrim një përgjigje të plotë dhe në kohë nga NJQV, kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
- adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- formatin në të cilin preferohet informacioni;
- çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

4

**Në ligjin e ri për
vetëqeverisjen vendore
"Ligji nr. 139/2015 "Për
vetëqeverisjen vendore"
Kreu VI: transparenca,
konsultimi dhe
pjesëmarrja qytetare",
NJQV kanë detyrimin
ligjor të krijojnë hapsira
për pjesmarrjen e
qytetarëve në
vendimmarrje.**

Më konkretisht lidhur me
transparencën:

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
- Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit².

² Neni 15: Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

5

Për Konsultimin publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV):

- Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.
- Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik³.

6

Lidhur me mbledhjet e Këshillit Bashkiak:

1. Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

3. Me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij⁴.

³ Neni 16: Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

⁴ Neni 17: Mbledhjet e këshillit të bashkisë

7

Pse është e rëndësishme pjesmarrja e qytetarëve në vendimmarrje?

Pjesmarrja e qytetarëve në vendimmarrje sjell:

- Krijimin e politikave dhe programeve të drejta, të cilat pasqyrojnë nevojat e vërteta, të pasuruara me përvojë dhe ekspertizë shtesë;
- Lehtësim të dialogut ndërsektorial dhe arritjen e konsensusit;
- Zbatim të zgjidhjeve të cilat janë strategjike dhe gjithëpërfshirëse;
- Siguron legjitimitetin në përputhshmëri me rregulloret e propozuara;
- Ulje të kostos, pasi palët mund të kontribuojnë me resurset e veta;
- Rritje të partneritetit, pronësisë dhe përgjegjësisë në zbatim;
- Fuqizim të demokracisë vendore - parandalimin e konfliktit mes grupeve të ndryshme dhe mes qytetarëve dhe NJQV-ve;
- Rritje të besimit në institucionet publike.

8

Si mund të bëhem pjesë e vendimmarrjes vendore:

- Duke u organizuar në grupe interesi për të adresuar çështje të cilat shqetësojnë komunitetin tënd;
- Duke marrë pjesë në diskutime që qeverisja vendore apo organizata jo fitimprurëse (OJF) organizojnë për hartimin e prioriteteve të zhvillimit dhe buxhetit;
- Duke u treguar aktiv dhe pjesmarrës në

diskutimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin e komunitetit tënd;

- Duke i dërguar një peticion/ankesë Bashkisë apo Njësisë Administrative;
- Duke marrë iniciativë llogaridhënuese në komunitetin tënd;
- Duke kërkuar informacion dhe llogari për shpenzimet publike, etj.

Ky publikim u realizua në kuadër të projektit "Monitorimi i programeve të transparencës në nivel lokal për një qeverisje demokratike", i zbatuar nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Social me mbështetjen e Programit të Grateve të Vogla të Ambasadës Amerikane.



**SHOQATA KOMBËTARE
E PUNONJËSVE SOCIALË
SHQIPËRI**

Rruga. Shyqyri Ishmi, Nr. 62/1, Tiranë
Web.www.albanian-nasw.com
E-mail: info@albanian-nasw.com,